



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË

17.06.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Prerje, transport, stivosje dhe pastrim parcele për dru zjarri

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime të korrjes së lëndëve drusore 77211100-3

Transporti i trungjeve në pyll 77211200-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,512,582 (shtatë million e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e dy) lekë, pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe pika 3, neni 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontrates që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. **Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.***

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, *ose* faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës., që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar një ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për të cilin duhet të paraqesë:

I - Kontraten e punës.

II – Çertifikatën si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave, të lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Kategoria, d - Zbatimin e projekteve në fushën e pyjeve, ku përfshihet zbatimi i projekteve të shfrytëzimit, të pyllëzimit dhe projektet që dalin në zbatim të objektivave të planit të mbarështrimit të pyjeve.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar në procesverbalin e mbajtur prej tij Nr. 4995/1 date 15.06.2026 si më poshte:

“Kriteri i mesiperme u vendos bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma b,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar, Vendim nr. 284, datë 29.4.2022 “Për përcaktimin e

rregullave, procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave”, i ndryshuar.

Punësimi i një eksperti të certifikuar në fushën e pyjeve dhe kullotave është i nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë objekt i kësaj kontrate dhe është bazuar në Vendimin nr. 284, datë 29.4.2022 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave” i ndryshuar.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

-Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar **2 persona** me profesion "**sharrëxhi**" për të cilët duhet të paraqiten:

I- Kontrata e punës

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar në procesverbalin e mbajtur prej tij Nr. 4995/1 date 15.06.2026 si më poshtë:

“Kriteri i mësipërm u vendos bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Udhezimin nr 2, date 03.03.2017, “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje “.

Duke qënë se në preventiv janë parashikuar zërat "Prodhim dru zjarri me motosharrë", Sharrim dru zjarri me motosharrë në fushën e druve" është e nevojshme që kontraktori të ketë të punësuar të paktën 2 persona me profesion "sharrëxhi".

2.2.4 Një punësim mesatar i të paktën 25 personave, për 6 mujorin e fundit dokumentuar kjo me vërtetimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga Administrata tatimore.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punes i argumentuar ne procesverbalin e mbajtur prej tij Nr. 4995/1 date 15.06.2026 si me poshte:

Kriteri i mësipërm u vendos bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr 2, datë 03.03.2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”.

Ky kriter u vendos me qëllim që të vërtetohet se operatori ekonomik ka fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e kësaj kontrate”.

Për prodhimin e druve të zjarrit në parcelë një skuadër e përbërë nga 3 persona (një nga këta është motoristi (sharrëxhi) prodhon në tetë orë 18.7 mst dru zjarri, 66 ditë * 18.7 mst = 1234 mst. Meqënëse ne kemi për të prodhuar 2689 mst dru zjarri duhen 2 skuadra pra duhen **6 persona**.

Transport me kafshë kemi për të transportuar 2689 mst / 66 ditë = 40.74 mst/ditë / 4 mst/ditë norma = **10.18 persona**.

Kemi për të ngarkuar 2689 mst / 66 ditë = 40.74 mst/ditë / 18 mst/ditë norma = **2.26 persona**.

Kemi për të stivosur 2689 mst / 66 ditë = 40.74 mst/ditë / 20 mst/ditë norma = **2.03 persona**.

Kemi për të sharruar 2689 mst / 66 ditë = 40.74 mst/ditë / 32 mst/ditë norma = **1.27 persona**.

Kemi për të transportuar më kamion 2689 mst / 66 ditë = 40.74 mst/ditë / 18 mst/ditë norma = **2.26 persona (Shoferët e kamionave)**.

1 (një) person është drejtuesi teknik i subjektit,

Pra në total 6 + 10.18 + 2.26 + 2.03 + 1.27 + 2.26 + 1 = 25 punëtorë.

Eshte vendosur periudha ”6 mujori i fundit” bazuar në Kreun XI, pika 1. d, e Udhëzimit nr 2, datë 03.03.2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”.

2.2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronësia
Kamion me kapacitet mbartës mbi 5 ton	Copë 2	në pronesi ose me qira
Motorsekë (motosharrë)	Copë 2	në pronesi ose me qira

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet, çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit.

Kur janë me qira të paraqiten: kontrata e qirasë vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me çertifikatën e pronësisë, lejën e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit.

(Ne rastin e mjeteve të marra me qira nga operatorët ekonomike bazuar në njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022, referuar dokumentacionit (leje qarkullimi, çertifikate e transportit të mallrave) , mjetet nuk duhet të rezultojnë për perdorim vetjak por për perdorim nga të tretet)

-Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk shënohen në regjistra publikë ofertuesi duhet të paraqesë dokumente që vërtetojnë pronësinë e mjeteve/pajisjeve dhe në rast se janë me qira duhet kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e tyre.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar ne procesverbalin e mbajtur prej tij Nr. 4995/1 date 15.06.2026 si me poshte:

“Kriteri i mesiperm u vendos bazuar ne neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 41, pika 4, gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022

Ky kriter u vendos me qëllim që të vërtetohet se operatori ekonomik ka mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës për arsye se në preventiv janë parashikuar zërat:

"Prodhim dru zjarri me motosharrë", "Sharrim dru zjarri me motosharrë në fushën e druve"- për të cilat nevojiten të paktën dy motorseka.

"Transport dru zjarri me automjete"- për të cilin nevojiten të paktën 2 kamiona nisur nga sasia dhe periudha kohore e realizimit të shërbimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për shërbimet objekt prokurimi të cilat do të ndihmojnë Autoritetin Kontraktor në proceset e punës për kryerjen e detyrave funksionale. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe neni 36, të LPP, si dhe neni 41 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni teknik ku janë përfshirë projektet teknike-ekonomike, specifikimet teknike, termat e referencës, afati i kryerjes të shërbimit dhe llogaritja e fondit limit, janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 557, datë 14.05.2026, sipas procesverbalit të mbajtur prej tyre

Ato janë bazuar në:

- Ligji nr 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”.

- VKM nr. 614, datë 23.10.2025 “Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor e të prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimin e rrugëve autopsyjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre”.

- Udhezimit nr 2, datë 03.03.2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”.

- Urdhrit të Ministrit të Mjedisit Nr. 190, datë 28.05.2026, “Për miratimin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit për vitin pyjor 2026-2027, për pyjet në pronësi publike, Bashkia Korçë”.

Llogaritja e fondit limit është bërë bazuar në tarifat dhe normat e miratuara me.

- VKM nr. 839, datë 30.12.2025 “Për miratimin e normave, standardeve, çmimeve bazë dhe praktikave më të mira në fushën e pyjeve”.
- Çmimet për transportin e largët janë marrë nga VKM. Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.
- Vendim nr. 776, datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”

Bazuar në ligjin nr 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, mbas hartimit të projekteve për secilën ngastër preventivave dhe analizave të çmimeve, ky dokumentacion është dërguar për miratim në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve me shkresën Nr. 5774, datë 03.06.2026.

Me shkresën Nr 610/1 prot, datë 10.06.2026, të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, protokolluar në Bashkinë Korçë, me Nr 5774/1 prot, datë 15.06.2026, Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka miratuar zbatimin e këtyre projekteve.

Dokumentacioni i hartuar nga grupi i punës bëhen pjesë e dokumentave të tenderit

NJËSIA E PROKURIMIT